

**V E N D I M**  
**Nr.476, datë 10.10.1994**

**PËR PROCEDURAT E STREHIMIT TË ISH TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE  
POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST**

Në mbështetje të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ndryshuar me ligjin nr.7828, datë 1.6.1994, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe të Komitetit të ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Kontigjent banesash për ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist konsiderohet vetëm ai kontigjent banesash, i cili sipas ligjit 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ndryshuar me ligjin nr.7828, datë 1.6.1994, kalon në pronësi të tyre falas. Komiteti i ish të Përndjekurve Politikë mbi këtë bazë të hartojë listat prioritare të strehimit për çdo rreth, që përfundimisht depozitohen për zbatim pranë organeve të pushtetit lokal dhe degëve të Entit Kombëtar të Banesave për çdo rreth.

2. Të gjithë ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, të cilët mendojnë se u takon strehim nga kontigjenti i banesave, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të paraqesin në zyrat lokale të Komitetit të ish të Përndjekurve Politikë vërtetime nga organet e pushtetit lokal që konsiderohen të pastrehë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.49, datë 29.1.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”.

3. Për efekt të zbatimit të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ndryshuar me ligjin nr.7828, datë 1.6.1994, do të përfitojnë banesë falas kategoritë e mëposhtme të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë që kanë fituar sipas ligjit statusin e ishtë dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist:

a) Njëri prej trashëgimtarëve të radhës së parë të personit të vdekur për shkak të përndjekjes që ka fituar statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 neni 3, shkronja “a”, kur konsiderohet i pastrehë.

Në rastin kur ka më shumë se një trashëgimtar të radhës së parë që konsiderohen të pastrehë, çështja zgjidhet me marrëveshje ndërmjet palëve. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, shteti njeh një detyrim me letra me vlerë vetëm për vleftën e një apartamenti (2+1) që u ndahet trashëgimtarëve të pastrehë në mënyrë të barabartë.

b) Ish të burgosurit politikë të përcaktuar si të tillë sipas shkronjës “b” të nenit 3 të ligjit “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” që konsiderohet i pastrehë ose njërit prej trashëgimtarëve të tij të radhës së parë që konsiderohet i pastrehë, kur vetë personi ka vdekur. Në rastin kur ka më shumë se një trashëgimtar të radhës së parë që konsiderohen të pastrehë, veprohet si në rastin që përcaktohet në paragrafin e dytë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij vendimi.

c) Ish të përndjekurve politikë që konsiderohen të pastrehë dhe që për 20 vjet me radhë kanë vuajtur masën e internimit e të dëbimit për motive politike, të përcaktuar si të tillë në nenin 3 pika “c” e ligjit “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”.

4. Personat që kanë fituar sipas ligjit statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, por që nuk konsiderohen të pastrehë dhe vazhdojnë të jetojnë në ish-qendrat e tyre të internimit, do të trajtohen me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 5, shkronja “c” të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, me ndryshimet e mëvonshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**